



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XIII-të (trembëdhjetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 24 korrik 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e Komunës, dhe filloi në orën 09:40.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, kurse munguan z.Demokrat Hodolli dhe znj.Naile Ahmeti,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, z.Fadil Babatinca përfaqësues nga Stacioni i Policisë në Podujevë, z.Zoltan Gazco dhe Laszlo Olah përfaqësues të KFOR – Podujevë.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, lexon pikat e rendit të ditës dhe pyet nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 30.06.2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 30 qershor 2023

2. Raporti i Punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për periudhën janar - qershor 2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, fjalën ia kaloi z.Liman Zeqirit si përgjegjës i zyrës komunale për komunitete dhe kthim i cili edhe e ka përgatitur dokumentin në fjalë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, e paraqiti raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, me siguri që do të flasim në pika të shkurta sepse kemi të bëjmë me një raport të gjatë që përfshinë shumë fusha dhe aktivitete. ZKKK ka angazhime pune dhe probleme të ndryshme por mbi të gjitha bashkëpunimi me qytetarë ekziston, jemi në shërbim të qytetarëve dhe kemi obligim për të kontribuar me mundësitë që i kemi sipas kërkesave të gjithë qytetarëve dhe në veçanti kërkesave të komuniteteve jo shumicë. Aktivitetet janë të shumta nga ne si ZKKK ku çdo javë hartojmë në formë të shkruar të gjitha aktivitetet dhe punën i adresojmë ku pastaj në formë fizike dhe elektronike i'a dërgojmë Kryetarit të Komunës sepse normale që si Zyrë jemi në kuadër të Zyrës së Kryetarit.

Po ashtu kemi bashkëpunim të mirë me Zyrën e Nënkryetares së Komunës dhe të gjitha Drejtoritë komunale, apo departamentet dhe shërbimet tjera që funksionojnë për qytetarët, përveç kësaj kemi bashkëpunim të mirë edhe me Kuvendin e Komunës së Podujevës si dhe me Ministrinë përkatëse të nivelit qendror. Natyrisht që kemi një koordinim të mirë edhe me Organizata të ndryshme Ndërkombëtare sidomos me OSBE, UNHCR dhe shume Organizata tjera të cilat na ndihmojnë në avancim, zhvillimi, implementim të dokumenteve dhe projekteve, në ekonomi dhe çështje tjera që ndërliken me komunitetet jo shumicë.

Duke u bazuar në të gjitha këto tema respekt të veçantë kemi edhe për faktorin e sigurisë që e falënderojmë çdo herë, me theks z.Fadil Babatincën nga Policia e Kosovës të cilin e kemi prezent në të shumtën e rasteve në mbledhjet e Komitetit por edhe për çështje tjera varësisht nevojave që paraqiten rreth sigurisë së qytetarëve në përgjithësi dhe komuniteteve jo shumicë në veçanti, dhe atë në nivelin më mirë të mundshëm.

Respekt të veçantë kemi edhe për KFOR të cilin e falënderojmë shumë që gjithëherë ka qenë prezent në të gjitha temat që i kemi diskutuar së bashku dhe janë të interesuar që Kosova të jetë një shtet i qetë, sovran, për të gjithë qytetarët.

Në këto rrethana kemi pas dhe kemi shumë takime dhe angazhime, mirëpo që të lexoj këtë material më duket se është paksa i gjerë dhe vetëm marrim kohë sepse i njëjti ju është përcjellë të gjithëve me kohë dhe keni mund ta shfletoni, pra është shkruar nga ZKKK e cila e përsërisë se në çdo kohë kemi bashkëpunim dhe koordinim të mirë me të gjithë për çka jemi të hapur për çdo gjë.

Nuk mund të them që të gjitha janë në rregull, kemi hapësirë që të veprojmë, punojmë, bashkëpunojmë dhe të realizojmë shumë projekte për Komunitetet jo shumicë në mënyrë që në kontinuitet të mund t'ia dalim bashkërisht.

Mendoj që Komuna e Podujevës është shembull si komunë me një qetësi absolute, është një komunë që vërtetë do ta quajë qytetërim. Ne ngaherë kemi dëshirë të merremi vetëm me anën e errët, por gjithmonë duhet t'i analizojmë edhe anët tjera që janë të mira, këtë e them pa keqkuptim nga askush.

Komuna e Podujevës ka realizuar shumë projekte dhe është në realizim e sipër pa dallime ngjyre, feje dhe në të gjitha sferat e jetës. Pra duhet të jemi të respektueshëm dhe të falënderojmë Komunën, institucionet komunale, Kryetarin e Komunës dhe të gjitha dikasteret që punojnë këtu si qeverisje lokale që jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve. Qytetarët janë ata që na vlerësojnë kurse ne duhet ti kryejmë detyrat tona sepse e kemi obligim dhe për atë paguhemi, për çka unë si shef i ZKKK çdoherë jam i gatshëm dhe i hapur që t'i koordinojmë punët me qytetarët, e me theks

për komunitetet jo shumicë sepse si Zyrë jemi për komunitetet jo shumicë të cilat adresë e kanë ZKKK në nivel lokal ku të gjitha planet, mundësit dhe vërejtjet mund t'i realizojnë.

Kohëve të fundit i kemi dy projekte shumë të rëndësishme apo dy plane ti quajë ashtu kushtimisht, është plani për integritet të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ku tani më 31 korrik është mbledhja e Kuvendit të Komunës në kuadër të të cilës janë paraparë edhe këto dy dokumente për shqyrtim dhe miratim pasi që i kemi kaluar të gjitha fazat e përgatitjes duke përfshirë edhe konsultimet publike dhe marrjen e komenteve e që jemi munduar që në mënyrën më të mirë ta përgatitim një dokument i cili natyrisht që pastaj mund të ketë edhe ndryshime varësisht analizës së zbatimit të tij.

Po ashtu kemi përgatitur edhe plani tjetër që është për integrimin e personave riatdhesuar dhe tash na është bashkuar edhe shtesa *azil kërkues*, fjala është të huajt, mirëpo me të gjithë këto që i kemi si projekte mendoj që do ti plotësojmë këto kushte dhe do të vazhdojmë tutje.

Rol të veçantë në këtë kanë DKA, DSHMS, DSHPMSH, DPUMM si dhe Drejtoritë tjera varësisht fushëveprimtarisë së tyre e që vërtetë jemi të kënaqur dhe do të vazhdojmë me punë tona dhe sukseset tona.

Për më shumë mund t'i gjeni në raportin në fjalë, mirëpo nëse ndokush ka ndonjë çështje, pyetje apo rekomandim urdhëroni mund të drejtoheni dhe do të mundohem t'iu kthej përgjigje dhe sqarimet e nevojshme.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, falënderoj shëfën e ZKKK për këto informata dhe për sjelljen e raportit në fjalë i cili sa kam lexuar është mjaft voluminoz dhe i qartë sa i përket punës dhe aktiviteteve të ZKKK duke përfshirë në disa raste edhe komunitetet jo shumicë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij raporti, nëse jo e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës, dhe kalojmë në pikën e radhës.

3. Raporti i punës së Zyrës për Integritet Europiane, për periudhën janar - qershor 2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, kemi të bëjmë me raportin e Zyrës për Integritet Europiane e që në kuadër të të cilës bënë pjesë edhe riatdhesimi. Sa jam në dijen unë nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës nuk ka pasë ndonjë të riatdhesuar, mirëpo për më shumë sërish mund të na informoj shëfi i ZKKK.

z.Liman Zeqiri, shëf i ZKKK, e paraqiti raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, sa i përket asaj që kryesuesi e theksoj kemi dy persona të riatdhesuar sipas dokumentacioneve që kemi në Zyrë, pra nuk ka dallime në këtë aspekt se a janë të komuniteteve jo shumicë apo asaj shumicë por konsiderohet si person i riatdhesuar, kjo ishte sa për fillim.

Lidhur me këtë proces në këtë Zyrë është zyrtari përkatës z.Ylber Salihu i cili edhe është kompetent dhe punon në kuadër të ZKKK.

Kemi të bëjmë me një proces i cili është në vazhdimësi dhe ka të bëjë kryesisht me raportin e progresit apo siç quhet ndryshe standardet tona si Kosovë. Jemi në dijeni të gjithë se ka shumë persona të cilët nuk kanë mundur t'i rregullojnë dokumentacionin përkatës në shtetet evropiane, pra në vitet e 90-ta kanë emigruar shumë njerëz në drejtim të shteteve të Evropës dhe tani në kuadër të kësaj Shteti i Kosovës pas shpalljes së pavarësisë ka nënshkruar dokumente me shtet e BE-së për riatdhesimin e një pjese të atyre personave që nuk e kanë të rregulluar dokumentacionin e qëndrimit në ato shtete.

Çështja e riatdhesimit pra ka të bëjë me ata që nuk kanë pasur mundësi të rregullojnë dokumentacionin në vendet e treta, dhe në kuadër të asaj Kosova i ka plotësuar kriteret që për çdo vit të kthehen deri në 5000 persona sepse duke bazuar në kapacitetet tona qoftë ekonomike qoftë politike, jeta dhe standardet nuk mund të përballohen, megjithatë kjo ka shkuar në mënyrë relative që nuk ka pasur mundësi të plotësohet ajo kuota ngase çdo komunë i ka edhe specifikat e veta.

Tani për këto çështje është ZKKK në kuadër të të cilës është zyrtari për integritet evropiane i cili merret me këtë proces, pra personat që vijnë nga vendet e BE-së, po sa të zbresin në aeroportin e Kosovës i'u merren biografite e tyre dhe shënime reale të tyre nga cili shtet vjen, mandej pas përfundimit të deklarimit ata drejtohen në ZKKK ku pastaj ne kemi të drejtën t'ia marrim një informacion, ku ka qenë, sa ka jetua atje, statusi dhe çështje tjera me rëndësi, dhe në bazë të atyre shënimeve, personi paraqet kërkesat e veta nëse ka nevojë për strehim, për çështje shëndetësore, për çështje sociale apo ka nevojë për çështje tjera. Megjithatë ne si Zyrë e pajisim me një dokument shtesë i cili është hera e parë që i'u japim si vërtetim e që pastaj i orientojmë ata persona te Enti i punësimit i cili është një organ që merret me këto çështje. Mandej ata persona i orientojmë, shembull, nëse ka afirmimet për një punë të vetën, që të shkojë në Qendrën për punë profesionale e cila gjendet në Prishtinë ku mund të pajisen me një certifikatë të aftësisimit profesional pas vijimit në Qendër për rreth 1 muaj, varësisht aftësive për ndonjë punë apo diçka të ngjashme.

Përveç neve si institucione të Republikës së Kosovës, janë edhe shumë Organizatat Ndërkombëtare që merren me këtë çështje, shembull, UNDP, IOM, OSBE, Giz-i Gjerman e të tjera të cilat kanë projekte të ndryshme e që ata persona që janë të certifikuar për aftësim profesional, kanë të drejtë të aplikojnë në projektet e tyre por edhe në projektet tona si Komunë në një vlerë deri në 3000.00€, por që të njëjtit i orientojmë edhe në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, qoftë për hapjen e ndonjë biznesi qoftë për nevoja tjera sepse ka të tillë që hapin biznese për vetëpunësim si akt i parë i tyre, mandej Komuna mund t'i ndihmon në forma të ndryshme për rritjen e kapaciteteve si dhe çështje tjera varësisht nevojave. Në këtë kontekst ka persona të riatdhesuar nga të gjitha komunitetet edhe pse nuk ka të dhëna sa i përket statistikave sipas gjinive, etnisë etj, pra nuk ka dallime, në këtë aspekt të gjithë janë të barabartë sa i përket trajtimit të tyre nga institucionet e nivelit lokal e që besoj se edhe ato të nivelit qendrorë. ZKKK më shumë është zyre orientuese, është Ministria e Punëve të Brendshme përmes Departamenteve përkatëse për personat e riatdhesuar, integritet dhe për të huaj, ajo që më së shumti ndan fonde dhe ndihmon këta persona. Tani nëse mund ta them kushtimisht kemi evoluim global dhe shumë persona po migrojnë dhe emigrojnë në vende të ndryshme, pra ka emigrime por unë e konsideroj emigrimin e hershëm më të theksuar si e drejtë legjitime në kërkim të një jete më të mirë, e që tani edhe Kosova po ka emigrim dhe atë kryesisht nga vendet e lindjes dhe Azisë, andaj për këtë arsye janë ndërmarrë veprime dhe janë hartuar dokumente dhe Strategji shtetërore e që në këtë aspekt edhe ne si Komunë kemi hartuar planin e veprimit për peronat e riatdhesuar, integritetin e tyre dhe peronat e huaj si azilkërkues siç kemi raste në Prishtinë, Lipjan dhe qytete tjera, pra kemi të bëjmë me këtë çështje si delikate nëse mund ta quaj me ët cilën tani për tani merret MPB mirëpo në të ardhmen besoj se kjo përgjegjësi do të kalojë edhe në nivelin lokal. Tani për tani është për t'u veçuar se kemi persona që vijnë nga vende të ndryshme të Botës të cilët kërkojnë në tregun e punës siç janë nga Nepali, Bangladeshi, etj, të cilët gjejnë një strehim këtu në Kosovë dhe një jetë më të qetë, të cilëve mandej mund t'iu rregullohet edhe statusi qoftë i përkohshëm qoftë i përhershëm.

Kjo që e potencova është në pika të shkurtra sa i përket procesit të riatdhesimit si çështje me të cilën merret ZKKK në kuadër të punëve dhe detyrave të veta, dhe në avancim e sipër vazhdimisht.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, duke falënderuar sërish shefin e ZKKK për këto sqarime, kërkoi nga të pranishmit nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj teme, mirëpo me që nuk pati të lajmëruar e konstatoi të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, dëshiroj t'ju njoftoj se ish anëtarja e këtij Komiteti znj.Naile Ahmeti ka dhënë dorëheqjen nga ky Komitet për arsye të shkuarjes së saj në Gjermani (është martuar).

Zyrtari i zyrës ligjore, i njofton të pranishmit rreth procedurës së zëvendësimit përkatësisht plotësim ndryshimin e përbërjes së Komitetit për Komunitete dhe i siguron që shumë shpejtë do të ndërmerren veprime për një gjë të tillë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi se të gjithë nxënësit e komuniteteve që e kanë përfunduar klasën e nëntë, e kanë kaluar provimin / testin arritshmëris e që është një sukses. Kujdesi nga ne të gjithë nuk ka munguar për çka falënderoj të gjithë.

Pra ky ishte vetëm sa për njoftimin e këtij komiteti.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, në mbledhjen e kaluar e patëm edhe temë sensibilizimin dhe informimin e opinionit për regjistrimin e nxënësve në shkolla të niveleve të ndryshme por edhe në arsimin e lartë, me theks atyre të komuniteteve jo shumicë. Pra sërish kërkoi nga të gjithë që të sensibilizojnë këta nxënës për tu regjistruan apo për të vazhduar shkollimin.

Natyrisht që ne si ZKKK dhe si Komunë do t'ju ndihmojmë me mjete të ndryshme të stimulimit qoftë me bursa dhe forma tjera sepse këtë e kemi edhe obligim, por vetëm kërkohet që të regjistrohen në shkolla dhe që të vazhdojnë shkollimin.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit duke i njoftuar anëtarët e komitetit se sipas planit të punës muaji gusht është përcaktuar të jetë pushim dhe të mos ketë mbledhje të komitetit, përveç ndonjë rrethane të jashtëzakonshme apo urgjente, andaj duke i'u dëshiruar pushime të këndshme, e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:05

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-016/01-0052412/23
Podujevë, 24 korrik 2023**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**